



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr.718, date 21.12.2000

PER

**SHPALLJEN PASURI KULTURORE TE DISA KALAVE DHE KESHTJELLAVE**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te neneve 2,16 dhe 17 te ligjit nr .7867, date 12.10.1994, "Per mbrojtjen e pasurise kulturore, te luajtshme dhe te paluajtshme", me propozimin e ministrit te Kultures, Rinise dhe Sporteve, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Shpallen pasuri kulturore:

1. Kalaja e Shkodres
2. Kalaja e Lezhes
3. Kalaja e Krujes
4. Kalaja e Durresit
5. Kalaja e Beratit
6. Keshtjella e Gjirokastres
7. Keshtjella e Porto-Palermos
8. Kalaja e Himares

2. Ngarkohet Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve qe, ne bashkepunim me Institutin e Monumenteve te Kultures, me Agjencine e Mbrojtjes se Mjedisit dhe me njesite e qeverisjeve vendore ne territoret e te cilave ndodhen objektet e percaktuara ne piken 1, te beje, brenda 30 diteve, percaktimin e kufijve te zonave te mbrojtura.

3. Ngarkohet Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve qe, brenda numrit te pergjithshem te punonjesve buxhetore, te miratuar, te miratoje strukturat e administrimit te ketyre objekteve.

4. Ngarkohen Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve dhe bashkete perkatese per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Ilir Meta**